# DËSHMI ARKIVI

**A-451877**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pas vendimit të Hagës, Richard Grenell shpërndan foton e Bleona Qeretit me bluzën "I love Hashim Thaçi" |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/lifestyle/pas-vendimit-te-hages-richard-grenell-shperndan-foton-e-bleona-qeretit-i586657` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 10:42:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 10:36:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 654bb7bdab647c9de2f0586c1d9b41e7ab728dc107966d509a6f2c0e01844e85 |
| TEKSTI | 910faa6d79e79a22f8464c23e7dcf1776f78e5f52a098720cb1973ca56af00d4 |
| PAMJA | 6085eaec3e056b6ca92442d770e0909b1406c18b80357f3ff55b920214be716f |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | c80984f061a192464ac61f0762123a24d1aee09a607061b0d98e2107fc740eab |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | aa9e18560c1a0d5b17c6b891acdb8aec89255b460c70dcb766ecaf13d039759d |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c80984f061a192464ac61f0762123a24d1aee09a607061b0d98e2107fc740eab`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pas vendimit të Hagës, Richard Grenell shpërndan foton e Bleona Qeretit me bluzën "I love Hashim Thaçi"

TemA
17 Shtator 2026, 12:36Lifestyle TEMA




Pas aktgjykimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë vijuar reagimet e shumta nga figura publike në Kosovë, Shqipëri dhe diasporë.

Një prej reagimeve që ka tërhequr vëmendje është ai i ish-emisarit amerikan për dialogun Kosovë-Serbi, Richard Grenell, i cili ka rishpërndarë në InstaStory një fotografi të këngëtares shqiptare Bleona Qereti.

Në fotografinë e publikuar nga Qereti, artistja shfaqet e veshur me një bluzë me mbishkrimin “I love Hashim Thaçi”, duke shprehur mbështetjen e saj për ish-presidentin e Kosovës.

Fotografia e Bleonës është rishpërndarë nga Grenell në llogarinë e tij në Instagram, në një kohë kur vendimi i Gjykatës Speciale ka nxitur reagime të shumta publike.

Qereti, e cila prej vitesh jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është shprehur vazhdimisht në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së gjatë procesit të tyre në Hagë. Edhe pas aktgjykimit, ajo ka vazhduar të publikojë mesazhe në mbështetje të Hashim Thaçit dhe Kosovës.

Në aktgjykimin e shpallur në Hagë, Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[35-vjeçarja arrestohet për vjedhje dhe bëhet virale për ngjashmërinë e 'frikshme' me divën e muzikës pop, Jennifer Lopez!]

11:45 Lifestyle

"Do ta harrojmë Dianën shumë shpejt"- Libri i vëllait të princeshës zbulon bisedën me mbretin Charles, ja çfarë i tha ai pak ditë para funeralit

11:02 Lifestyle

[FOTO/ U bë nënë për herë të parë, Lady Gaga fotografohet për herë të parë me foshnjen e saj në rrugët e Los Angeles]

10:18 Lifestyle / 1 koment

[FOTOT/ Kim Kardashian dhe Hamilton arratisje romantike në Liqenin e Komos, çifti fotografohet në një varkë]

09:00 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.